



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 67 dt. 15.09.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, si dhe të nenit 22, pika 3, të rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 15.09.2014, pasi shqyrtoi materialin mbi mungesën e drejtuesit teknik z.Kliti Kallamata, për shoqërinë “E SHKUARA PËR TË ARDHMEN” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Pezullimin e licensës së restaurimit R.SH.6 për shoqërinë “E SHKUARA PËR TË ARDHMEN” sh.p.k. deri në ripajisjen me licensë restaurimi të drejtuesit të saj teknik.
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, pezullimin e licensës në fushën e restaurimit R.SH 6, për shoqërinë “E SHKUARA PËR TË ARDHMEN” sh.p.k., me drejtues ligjor z. Kliti Kallamata.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI